



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 536/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohet programi i studimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, Bachelor Profesional, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit, BSc, 180 ECTS, dhe Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, Bachelor Profesional, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit	BSc	180	Afrim Loku, Bashkim Thaçi dhe Bujar Pira
2	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri	Bachelor Profesional	180	Ismet Malsiu, Florit Hoxha dhe Halit Mehmeti

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj më 15.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Lina Nunes dhe Laura Bouriaud.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë